STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 15 mars 2013

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON RIMBURSIMIN FEDERAL PER QYTEZEN SKARSDEILL (SCARSDALE) PER KOSTOT E SUPER STUHISE SENDI (SANDY)

Guvernatori drejton mbi 100,000 dollarë në fonde të miratuara nga FEMA tek Skarsdeill (Scarsdale) për kostot e pastrimit pas super stuhisë Sendi (Sandy)

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se Shteti i Nju Jorkut (New York State) ka siguruar 115,015 dollarë për Qytezën e Skarsdeill (Scarsdale) në Qarkun Uestçestër (Westchester County) për rimbursimin e kostove të pësuara nga Qyteza pas pasojave të super stuhisë Sendi (Sandy). Si rezultat i stuhisë rreth 30,000 jardë kub mbeturina bimore të rrezikshme u depozituan në rrugë, parqe dhe kalime anembanë qytetit. Skarsdeill (Scarsdale) përdori punën dhe pajisjet e qytezës, si dhe pajisje me qira dhe kontraktorë për të marë dhe transportuar mbeturinat bimore dhe pemët në vendet e hedhjes së përkohëshme dhe pakësimit.

"Nga Long Ajlënd (Long Island) përmes Qytetit të Nju Jorkut (New York City) dhe deri në komunitetet e Luginës së Hadsonit të Poshtëm (Lower Hudson Valley) si Skarsdeil (Scarsdale), udha shkatërruese e Sendit (Sandy) gjëmoi përmes komuniteteve duke lënë dëm të konsiderueshëm pas," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). "Qytezës iu desh të reagonte shpejt me burimet që kishte në dispozicion dhe gjithashtu të kontraktonte njësi private duke ditur sasinë e madhe të dëmit të shkaktuar nga stuhia. Jam shumë i gëzuar të jem në gjendje që të drejtoj këto fonde përseri tek qyteza dhe t'i ndihmoj ata të vazhdojnë në përpjekjet e tyre të përgjithshme për rimëkëmbje."

"Super stuhia Sendi (Sandy) shkaktoi dëm të konsiderueshëm dhe krijoi sasi të mëdha mbeturinash. Skarsdeill (Scarsdale), si shumica e komuniteteve të prekura, përballoi kosto të jashtëzakonshme për pastrimin e këtij shkatërrimi menjëherë pas stuhisë. Ky rimbursim do të ndihmojë Qytetin që të trajtojë këto shpenzime të paplanifikuara dhe të lehtësojë ndikimin financiar të stuhisë në komunë," tha Senatorja) Andrea Stjuart-Kanzëns (Andrea Stewart-Cousins).

Anëtarja e asamblesë Emi Pollin (Amy Paulin) tha, "Banorët e Skarsdeillit (Scarsdale), përfshirë edhe unë, janë shumë mirënjohës që Guvernatori Kuomo (Cuomo) dhe përfaqësuesit e FEMA-s e kuptuan sesa i konsiderueshëm ishte dëmi nga kjo stuhi e tmerrshme. Detyra e pastrimit pas super stuhisë Sendi (Sandy) ka qënë e përfshirëse dhe e shtrenjtë, kështu që këto fonde nga FEMA janë mëse të mirëpritura.

Përpjekjet e restaurimit vazhdojnë dhe këto fonde do t'a bëjnë përfundimin e kësaj detyre shumë më të lehtë."

"Rikthimi i komuniteteve të dëmtuara nga super stuhia Sendi (Sandy) është përparësia më e lartë e departamentit tonë dhe këto fonde të rimbursimit të Ndihmës Publike do të ndihmojnë secilin nga komunitetet e prekura që të rivendosin në rregull punët fiskale të tyre," tha Komisioneri i Seksionit të Sigurisë së Atdheut dhe Shërbimeve të Urgjencës të NYS-së (NYS Division of Homeland Security and Emergency Services Commisioner) Xherom M. Hauër (Jerome M. Hauer).

Dhënia e këtyre fondeve federale është pjesë e rimbursimeve në vazhdim dhe në pritje në të ardhmen që shteti do të administrojë dhe paguajë tek komunat e prekura. Komunat janë duke u rimbursuar mbështetur në një shumëllojshmëri projektesh që përfshijnë ndërtimin dhe shkatërrimin, heqjen e mbeturinave ranore dhe bimore, aktivizime të EOC-së, largime, kontrolle dhe riparime dhe rivendosje emergjente të teknologjisë së informacionit dhe programin Strehimi dhe Energjia Thelbësore e Përkohëshme (Sheltering and Temporary Essential Power) (STEP). Shteti do të vazhdojë t'i bëjë këto pagesa të rimbursimeve ndërsa FEMA jep fondet.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418